



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË  
KANDIDATIT PËR KRYETAR BASHKIA PUSTEC, Z. EDMOND THEMELKO NË ZBATIM TË  
LIGJIT NR.138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË  
ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 19.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar Bashkia Pustec, z. Edmond Themelko në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa a, i Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



**Nr . 588 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Pustec, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

## VËREN

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", "Aleanca e Maqedonasve për Integrim European" ka depozituar në KQZ Kërkesën për rregjistrimin e z. Edmond Themelko si kandidat për kryetar të bashkisë Pustec.

Gjithashtu z. Edmond Themelko në përputhje me nenin 5, pika 4, gërma "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton z. Edmond Themelko ka deklaruar:

Dënuar me 3 muaj burgim (me kusht një vit për kundërvajtje penale) për veprën penale neni 23 i ligjit për akcizën në Maqedoninë e Veriut me vendim të Gjykatës së Komunës së Strugës K.Nr.75/95, datë 21.09.1995.

Ka deklaruar se është hetuar nga Prokuroria speciale e Maqedonisë së Veriut për rastin "Titanik", me datë 17.2.2016-deri me 15.0.2016 amnistuar nga Presidenti i Republikës me vendim nr. 535/8 datë 12.04.2016 për manipulime zgjedhore.

Prokuroria Strugë, për tregti me canta, ligji për Akcizën, me datë 21.09.1995, Rehabilituar me vendimin KS, KR.NR.36/16, datë 21.03.2016 bërë fuqi plotë me 11.04.2016

Prokuroria speciale e Maqedonisë së Veriut, Shkup për ndikim zgjedhor, me 17.02.2016, Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim nr.08-856/5 Dtë 12.04.2016 anuloi amnistinë e dhënë me nr.535/8 datë 12.04.2016. për këtë arsye kanë rifilluar hetimet e pushuara për këtë rast. Aktualisht materialet janë duke u gjykuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkup 1 dhe çështja është në procedurë.

Policia e Strugës, për tregti me canta, Ligji për Akcizën, datë 21.09.1995, i liruar datë 21.09.1995.

Policia e qytetit të Resnjës, me kërkesë të prokurorisë Speciale të Maqedonisë së Veriut, datë 12.02.2016, liruar me datë 12.2.2016

Prokuroria Speciale e Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të prokurorisë Speciale e Maqedonisë së Veriut, arrestuar me vendimin KOK-Kr- Nr.198/17 datë 15.09.2017 prej autoriteteve maqedonase është bërë për shkak se kam qarkulluar me dokumente identifikimi shqiptare ndërkohë që autoritetet maqedonase për shkak të rifillimit të hetimeve pas prishjes së vendimit të amnistisë nga Presideneti i republikës me kishin bllokuar dokumentin e identifikimit maqedonas, me vendimin nr. KOK-Kr.228/17 datë 25.11.2017 është ndryshuar masa e sigurimit nga arrest në burg në arrest shtepie. Me vendimin KOK-Kr.Nr. 777/18 datë 09.11.2018 është ndryshuar masa e arrestit të shtëpisë me detyrim paraqitje.



**Nr . 588 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Pustec, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Gjykata e qytetit Resnje, per nenin 394, faqe 2, nr.159, faqe 2, nr. 24 dhe nr.45, për manipulime zgjedhore,amnestuar nga presidenti i republikës së Maqedonisë së Veriut me nr.535/8, datë 12.04.2016 si dhe vendimi i Gjykatës Shkup1, II KOK PP nr. 42/16-7, datë 15.04.2016, periudha 17.02.2016-15.04.2016.

Gjykata e rrethit gjyqësor Shkup 1, Shkup, Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni-nuk e mbaj mend, për manipulime zgjedhore, arrestuar me vendimin KOK-Kr br. 198/17, datë 15.09.2017 prej autoriteteve Maqedonase është bërë për shkak së kam qarkulluar me dokumente identifikimi shqiptare ndërkohë që autoritetet maqedonase për shkak të rifillimit të hetimeve pas prishjes së vendimit të amnistisë nga Presidenti i Republikës më kishin bllokuar dokumentin e identifikimit maqedonas. Me vendimin nr. 228/17 është ndryshuar masa e sigurimit nga arrest në burg me arrest shtëpie. Me vendimin KOK-Kr.nr.777/18 dt.09.11.2018 është ndryshuar masa e arrestit të shtëpisë me detyrim paraqitje.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr.1 38/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes dhe zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore, sipas së cilës rezulton se z. Edmond Themelko është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Nga verifikimi prima face i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit dhe vërtetimit të gjendjes gjyqësore) sipas nenit 2, dhe nenit 4, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", rrethanat e paraqitura nga z. Edmond Themelko, nuk përfshihen në kushtet e ndalimeve për kandidim dhe për t'u zgjedhur në funksionin e deputetit.

Për sa i përket ndalimeve të parashikuara në nenin 2, pika 2 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për ndalime, procedime masa sigurimi të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kreu V, pika 2, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", është Prokuroria e Përgjithshme, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Sipas dispozitave të sipërcituara, procedura e verifikimit, sipas kësaj pike, nuk pengon vijimin e procedurave për zgjedhjen, emërimin apo ushtrimin e funksionit.



**Nr . 588 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Pustec, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të Kreut V të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit konstaton se dhënat e deklaruara nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit sipas ligjit 138/2015.

Gjithashtu KQZ ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, gërma "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, 6 të nenit 9 të udhëzimit nr. 2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve", KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për rregjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkia Pustec, Qarku Korçë, të propozuar nga Partia "Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa a, e Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, gërma f, të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

### **VENDOSI:**

1. Njoftimin e KZAZ-së nr. 69 për vazhdimin e procedurave për rregjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkia Pustec, Qarku Korçë, të propozuar nga "Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr . 588 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Pustec, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".